



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 142/3 Prot

Tiranë, më 17.05.2022

V E N D I M

Nr. 67, datë 17.05.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të konkurrimit për shpalljen #3761 – “Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Kulturës” dhe atë me kod #3781 - “Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, mbi trajtimin e informacionit, për vlerësim të padrejtë në dy procedura konkurimi,

VËREJ SE:

Në informacionin e regjistruar me nr. 1105 prot., datë 24.12.2021, konkurrenti ***** , pretendon se skualifikimi i tij në disa procedura konkurimi, të publikuara në faqen zyrtare të DAP, është i padrejtë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mbledhur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, konstatohet që konkurrenti në fjalë, ka aplikuar dhe ka marrë pjesë në konkurrim nëpërmjet procedurës për ngritje në detyrë, në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues, shpallur me kod #3761 – “Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe

Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Kulturës” dhe atë me kod #3781 - “Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”. Në përfundim të procesit, në të dy këto konkurrime, nëpunësi në fjalë nuk është shpallur fitues.

Duke mos qenë dakord me këtë fakt, konkurrenti *****, është ankuar pranë njësisë përgjegjëse, duke parashtruar pretendimet dhe kundërshtitë e tij në lidhje me vlerësimin. Në thelb të pretendimeve të tij, parashtrohet se nuk është vlerësuar drejt nga ana e Komisionit të Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND), përsa i takon jetëshkrimin, pasi i janë vënë më pak pikë nga sa meriton e më tej, Departamenti i Administratës Publike nuk ka mbajtur të njejtin standard vlerësimi për procedura të ndryshme konkurrimi dhe metodologji vlerësimi, megjithëse kriteret e vlerësimit dhe objekti kanë qenë të njejtë.

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit me nr. 142 prot., datë 03.02.2022 “*Kërkesë dokumentacioni për verifikimin e kërkesës së kandidatit *****, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit me kod # 3761 dhe asaj me kod #3781*”, Departamenti i Administratës, me anë të shkresës sqaruese me nr. 142/1 prot., datë 17.02.2022, ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil se kandidati *****, ka paraqitur ankesë me të njëjtat pretendime edhe pranë institucionit të tyre.

Nga ana e tij, Departamenti i Administratës Publike ka kryer hetimin administrativ mbi ankesën e kandidatit në fjalë dhe në përfundimin, ka njoftuar edhe Komisionerin duke sqaruar hollësisht për procedurën e ndjekur dhe konkluzionet e arritura.

Nga përmbajtja e aktit si më sipër, rezulton se Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND) është mbledhur dhe ka shqyrtuar ankesën e kandidatit ***** dhe, pasi ka bërë rivlerësimin e jetëshkrimin, ka arritur në të njëjtin përfundim, duke konfirmuar se kandidati në fjalë nuk shpallet fitues e për këtë ka informuar edhe ankuesin.

Po kështu, në lidhje me pretendimin se Departamenti i Administratës Publike nuk ka mbajtur të njejtin standard vlerësimi për procedura të ndryshme konkurrimi dhe metodologji vlerësimi megjithëse kriteret e vlerësimit dhe objekti kanë qenë të njejtë, DAP thekson se procedura të cilës ankuesi i referohet dhe që ka konkurruar, është lëvizje paralele në kategorinë e ulët drejtuese. Konkretisht bëhet fjalë për shpalljen me kod #3770 – Përgjegjës i Shërbimeve në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Brendshme.

Departamenti i Administratës Publike, në shkresën e tij sqaruese, me të drejtë parashtron se vlerësimi i kandidatëve që konkurrojnë në lëvizjen paralele është i ndryshëm nga ajo e ngritjes në detyrë. Vlerësimi i elementëve të jetëshkrimin është realizuar duke patur parasysh

gjithashtu, kërkesat e posaçme për pozicionin e punës dhe dokumentacionin në dosjen e kandidatit.

Pasi u administruan dhe u shqyrtuan të gjitha aktet e paraqitura në kërkesën e konkurrentit dhe ato të dërguara nga ana e Departamentit të Administratës Publike, duke renditur dhe analizuar pretendimet e paraqitura, rezultoi që:

- Pretendimi se nuk është vlerësuar siç duhet nga ana e Komisionit të Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND), përse i takon jetëshkrimit, duke u vlerësuar me më pak pikë nga sa meriton, gjendet i pabazuar.

Nga përmbajtja e materialit të administruar konstatohet se, në të dyja procedurat e konkurrimit për ngritje në detyrë, janë ndjekur saktë hapat e kërkuar ligjorë, duke filluar nga shpallja me kriteret që duhej të plotësonin kandidatët pjesëmarrës, deri te njoftimi individualisht i kandidatëve që kanë konkurruar dhe publikimi i vendimit të përzgjedhjes së kandidatit fitues me më shumë pikë, siç përcaktohet në nenet 25 e 26, të ligjit nr. 152 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në kreun III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, i ndryshuar,

Duke filluar me ngritjen e KPND, evidentohet që anëtarët e tij janë përzgjedhur në bazë të Kreut III “Ngritja në detyrë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”; ky komision është përbërë nga 5 (pesë) anëtarë dhe në caktimin e tyre janë mbajtur parasysh parashikimet e pikës 7, të kreut III, të vendimit si më sipër.

Edhe mënyra si ka vepruar KPND, është në përputhje me kërkesat ligjore; secili nga anëtarët e ka vlerësuar çdo pyetje me pikë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. Në të dyja konkurrimet përfundimet e arritura janë konfirmuar me vendim unanim të të 5 anëtarëve të komitetit.

Në vijim, kandidati ***** ka ushtruar të drejtën e ankimit në KPND për rezultatin e pikëve, i cili gjatë shqyrtimit të ankesës ka bërë një rivlerësim të gjithë elementëve të jetëshkrimit, ku janë përfshirë: arsimi, eksperiencia, trajnimet e lidhura me fushën, vlerësimi më i fundit i punës, si dhe kërkesat e posaçme për pozicionin e punës bashkë me dokumentacionin në dosjen personale të kandidatit. Në fund të rivlerësimit është arritur në të njëjtin përfundim dhe konkurrenti përsëri nuk është shpallur fitues. Vendimi përfundimtar i është njoftuar kandidatit, sipas pikës 35, të kreut III, të vendimit si më sipër.

Nisur nga sa më sipër, siç shihet nga ana e njësisë përgjegjëse dhe KPND, janë zbatuar me korrektësi procedurat e përcaktuara në aktet përkatëse dhe argumentimi i këtij të fundit për

përfundimet ka qenë i arsyeshëm, prandaj pretendimi i konkurrentit *****, për vlerësim të pasaktë të jetëshkrimit, nuk mund të merret në konsideratë.

- Pretendimi tjetër se Departamenti i Administratës Publike nuk ka mbajtur të njejtin standard vlerësimi për procedura të ndryshme konkurrimi, vlerësohet i pambështetur në ligj, pasi kriteret e përgjithshme të vlerësimit të kandidatëve përcaktohen sipas kategorisë së pozicioneve në të cilin konkurrohet, e shprehur kjo në ligjin nr. 152 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në kreun III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, i ndryshuar.

Nga analiza e fakteve dhe pretendimeve të paraqitura, konstatohet se bëhet fjalë për ndryshime të vlerësimit në procedurat për ngritje në detyrë (për shpalljen #3761 – “Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Kulturës” dhe atë me shpalljen #3781 - “Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”) dhe procedurën për lëvizje paralele (shpallja me kod #3770 – Përgjegjës i Shërbimeve në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Brendshme).

Përsa i takon mënyrës së funksionimit të KPLP dhe KPND, procesit të vlerësimit në procedurat e lëvizjes paralele dhe asaj të ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese, si dhe pranimin në shërbimin civil, Departamenti i Administratës Publike bazohet në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil..”, në të cilin janë përcaktuar përbërja e komiteteve sipas kategorisë së pozicionit të punës, si dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve.

Referuar sa më sipër, mënyra e vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë në procedurën e lëvizjes paralele është e ndryshme nga ajo e ngritjes në detyrë. Kështu, procedurat e lëvizjes paralele në kategorië e mesme dhe të ulët drejtuese, vlerësohen nga Komiteti i Pranimin për Lëvizjen Paralele (KPLP) me 3 (tre) anëtarë në përbërjen e tij, sipas përcaktimeve në pikën 16, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015. Më pas, në zbatim të pikës 21 të dispozitës në fjalë, përcaktohet struktura e ndarjes së pikëve për vlerësimin e kandidatëve, që është:

1. 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
2. 60 pikë për intervistën me gojë.

Nga ana tjetër, në procedurat për ngritje në detyrë në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese, vlerësimi kryhet nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në detyrë (KPND), në përbërje të të cilit ka 5 anëtarë, të cilët kanë autoritetin të bëjnë vlerësimin e kandidatëve sipas pikës 27 dhe 28, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, sipas strukturës së mëposhtme:

1. 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
2. 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
3. 40 pikë për testimin me shkrim.

Në përfundim të analizës së gjithë sa u tha më sipër, arrihet në konkluzionin se në procedurat e konkurrimit me shpalljen #3761 – “*Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Kulturës*” dhe atë me shpalljen #3781 - “*Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit*”, njësia përgjegjëse, ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese*”, dhe në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese...*” të Departamentit të Administratës Publike.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 90 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë për moskualifikimin e nëpunësit ***** në procedurat e ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit të mesëm drejtues “*Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Kulturës*” dhe

“Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit” dhe, meqënëse nuk gjenden elementë kundraligjshmërie në administrimin e këtyre konkurrimeve, të bëhet arkivimi i çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike dhe konkurenti *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha